



AGJENCIA E STATISTIKAVE TE KOSOVËS

RAPORTI
VJETOR

| 2021

Prishtinë, 2022

<https://ask.rks-gov.net/>



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansija, Rada i Transfra

Ministry of Finance, Labor and Transfers

Agjencia e Statistikave të Kosovës -Agencija za Statistike Kosova -Kosovo Agency of Statistics



RAPORTI VJETOR 2021

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

Faqe

PËRMBAJTJA	3
LISTA E SHKURTESAVE	4
HYRJE	6
1. PERFORMANCA E ASK-së... ..	8
1.1. Korniza Ligjore dhe dokumentet bazë	8
1.2. Këshilli Statistikor	9
1.3. Bashkëpunimi dhe Komunikimi	9
1.4. Llogaritë Kombëtare	14
1.5. Statistikat Ekonomike	16
1.6. Statistikat Sociale	18
1.7. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit	19
1.8. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare	20
1.9. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informativë	21
1.10. Racionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve në ASK	26
1.11. Pasqyrat e Performancës së ASK-së	27
<i>Fusha e Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare.</i>	32
<i>Fusha e Statistikave Sociale</i>	34
<i>Fusha e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit</i>	35
<i>Fusha e Statistikave të Metodologjisë dhe TI-së</i>	36
2. ANALIZA E PRIORITETEVE	39
3. BUXHETI	42
4. SFIDAT	44
SHTOJCA 1. Pasqyra e të punësuarve në Shërbimin Civil të Kosovës në ASK, dhjetor 2021	45
SHTOJCA 2: Kalendar i publikimeve 2021	46

LISTA E SHKURTESAVE

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARC	-	Agjencia për Regjistrimin Civil
AEB	-	Anketa e Ekonomive Bujqësore
ABEF	-	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
AFP	-	Anketa e Fuqisë Punëtore
APR	-	Anketa Post Regjistruese
ASK-data	-	Platformë e bazuar në PX-Web
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BB	-	Banka Botërore
BPV	-	Bruto Produkti Vendor
DLLK	-	Departamenti i Llogarive Kombëtare
DSE	-	Departamenti i Statistikave Ekonomike
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale
DSBM	-	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DAM	-	Departamenti i Administratës dhe Mbështetjes
DMTI	-	Departamenti i Metodologjisë dhe i Teknologjisë Informative
DPPKK	-	Departamenti për Politika, Planifikim, Kordinim dhe Komunikim
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IKShPK	-	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IÇIMP	-	Indeksi i Çmimeve të Importit
IHÇK	-	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IKN	-	Indeksi i Kostos së Ndërtimit
KVP	-	Korniza e Vlerësimit të Performancës
LLKV	-	Llogaritë Kombëtare Vjetore
LLKT	-	Llogaritë Kombëtare Tremujore
MeM	-	Marrëveshje e Mirëkuptimit
MFPT	-	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
OZHQ	-	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
MASHTI	-	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
PSZ	-	Programi i Statistikave Zyrtare
PVSZ	-	Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare
P5VSZ	-	Plani 5 Vjeçar i Statistikave Zyrtare
PKZMSA	-	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PP	-	Pilot Projekt
STJ	-	Statistikat e Tregtisë së Jashtme
SIPK (ang)	-	Sistemi i Përdorimit të Kohës
TM	-	Tremujor
TI	-	Teknologji Informative
TIK	-	Teknologjia Informative dhe Komunikimi
ZKM	-	Zyra e Kryeministrit
BoP (ang)	-	Bilanci i Pagesave

CoP (ang.)	-	Kodi i Praktikave të Statistikave Evropiane
CAPI (ang.)	-	Intervistimi Personal i Asistuar nga Pajisjet e dorës, Celularë ose Tabletë
CATI (ang.)	-	Intervistimi me Telefon i Asistuar nga Kompjuteri
CAWI(ang.)	-	Mbledhja e të dhënave përmes një shfletuesi (broëser) online.
EUROSTAT(ang.)	-	Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian
ESA 2010(ang)	-	Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare
ECP(ang.)	-	Programi i Krahasueshmërisë Evropiane
EU (ang.)	-	Bashkimi Evropian
ESMS (ang)	-	Struktura e Metadatave Euro-SDMX
ESQRS (ang)	-	Standardi ESS për Strukturën e Raporteve të Cilësisë
ESS (ang)	-	Sistemi Evropian Statistikor
ESDS (ang.)	-	Promovon dhe ofron mbështetje për të gjithë përdoruesit që janë të interesuar për të dhënat e ASK-së
e-GDDS(ang.)	-	Shpërndarja e të dhënave
eDAMIS (ang.)	-	Raportimi i të dhënave përmes Platformës së krijuar nga Eurostati
GIS (ang.)	-	Sistemi Informativ Gjeografik
GSPBM (ang.)	-	Modeli i Përgjithshëm për Përpunim të Fazave Statistikore
IPA (ang.)	-	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
ISBN (ang.)	-	Numri Standard Ndërkombëtar i Librit
ISCED 2011(ang.)	-	Nomenklatura për Klasifikim të Nivelit të Arsimit
IOM (ang.)	-	Organizata Ndërkombëtare për Migracion
ISS (ang.)	-	Statistikat e Shoqërisë së Informacionit
MICS (ang.)	-	Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë
NSDP (ang.)	-	Faqe e Përmbledhjes Kombëtare
NACE (ang.)	-	Nomenklatura për Klasifikimin e Aktiviteteve Ekonomike
OECD (ang.)	-	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PRODCOM (ang)	-	Klasifikimi i Produkteve
PAPI (ang.)	-	Përdorimi i pyetësorëve në letër
Px-Axis	-	Platformë për Shpërndarjen e të Dhënave
SIDA (ang.)	-	Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
SDMX (ang)	-	Shkëmbimi i të Dhënave Statistikore dhe Metadatat
SDG (ang.)	-	Treguesit e Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SEE2020 (ang)	-	Strategjia e Vendeve të Evropës Juglindore 2020
SILC (ang.)	-	Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës
SMIS+(ang.)	-	Sistemi i Inteligjencës së Menaxhimit të Sigurisë
TAIEX	-	Zyra e Shkëmbimit të Informacionit të Asistencës Teknike (e BE-së, për vendet e ardhshme anëtare)
UNHCR (ang.)	-	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UN (ang.)	-	Kombet e Bashkuara
UNICEF(ang.)	-	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNDP (ang.)	-	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA (ang.)	-	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Aktivitetet e Popullsisë

HYRJE

Edhe përkundër faktit, se situata me COVID 19 edhe gjatë vitit 2021 ishte jo e mirë në aspektin e qasjes në ekonomi familjare dhe sigurimit të stafit shtesë për mbledhjen e të dhënave, megjithatë është përmbytur programi i aktiviteteve të parapara me Planin e Punës 2021. Në aspektin e veprimit, viti 2021, ishte më i lehtë se sa viti 2020 për shkak të lehtësimit të masave nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ashtu që, ASK, reflektoi dhe reagoi në përputhshmëri dhe ndoqi udhëzimet dhe masat e miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në përgjigje ndaj situatës së krijuar, ASK bëri të mundur furnizimin e stafit me pajisje në mënyrë të bëhet e mundur puna edhe nga distanca, sidomos për stafin kyç të cilët ishin përgjegjës për aktivitete respektivisht realizimin e produkteve statistikore përkatëse.

Në procesin e anketave në të cilat të dhënat mblidhen drejtpërdrejt nga subjektet afariste, mbledhja e të dhënave ishte me vështirësi megjithatë është zbatuar plotësisht. Por në disa raste në veçanti tek sektori i amvisërive mbledhja e të dhënave ishte bërë me pak vonesa sidomos tek të dhënat e Tregut të Punës dhe Anketa e Ekonomive Bujqësore.

Për shkak të vështirësive KAS, u përqendrua edhe më shumë në mbledhjen e të dhënave me metodat CAPI dhe CATI si dhe në raste të caktuara përmes telefonit e sidomos në ri anketime të ekonomive familjare. Përkundër vështirësive nga rrethanat e pandemisë COVID 19 dhe pamundësisë për të rekrutuar staf te rregullt për zëvendësimin e pozitave të lira nga procesi i pensionimit apo staf me kontrata te veçantë për angazhim të përkohshëm ASK, arriti të përmbytur në masën më të madhe Programin e saj të Punës për vitin 2021.

Në rrethana të tilla, ASK në bashkëpunim me Institucionet tjera te Republikës së Kosovës, u bë e mundur koordinimi me Agjencinë e punësimit për të angazhuar stafin i cili ishte në pritje të angazhimit nga Agjencia e punësimit të Republikës së Kosovës. Andaj përmes kësaj marrëveshje u bë angazhimi i një numri të caktuar përmes procedurave në fuqi si dhe më pas trajnimi i stafit sipas fushave përkatëse për mbledhjen e të dhënave nga terreni. Si rezultat i angazhimeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të realizuar qëllimet e Planit Vjetor të Punës 2021, ASK në fund të vitit ka arritur të realizoj 65 produkte statistikore, 119 raporte statistikore të publikuara, 113 prej tyre janë realizuar në kohë, duke përmbytur mbi 93% të Programit të hulumtimeve statistikore.

Në aspektin ligjor dhe mandator, Raporti Vjetor i Punës për vitin 2021 përgatitet në përputhje me Ligjin për Statistikat Zyrtare (LIGJI Nr. 04/L-036, si dhe LIGJI NR. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e LIGJIT Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës), përmes të cilit prezantohen të gjitha aktivitetet kryesore, të realizuara sipas Planit të Punës të vitit përkatës. Informatat e prezantuara në këtë Raport kanë për qëllim ta mbajnë të informuar përdoruesin, institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare, për të arriturat dhe sfidat e Sistemit Statistikor të Kosovës, gjatë vitit 2021.

Një nga instrumentet për matjen e performancës dhe adresimin e sfidave të Sistemit Statistikor të Kosovës, sidomos për ASK-në, vazhdon të mbetet Raporti Vjetor i Punës. Duke qenë e vetëdijshme për nevojat dhe kërkesat, gjithnjë në rritje të shfrytëzuesve për të dhëna statistikore cilësore, ASK-ja e ka përfshirë në Planin Vjetor të Punës 2021 listën e prioriteteve të aktiviteteve hulumtuese.

Viti 2021 ishte viti i katërt në kuadër të zbatimit të Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare 2018- 2022. Gjatë periudhës raportuese, përveç hulumtimeve të rregullta, gjithashtu janë zhvilluar edhe një numër i caktuar i anketave për herë të parë si anketa Dhuna në Baza Gjinore e cila ende vazhdon edhe gjatë vitit 2022, Përpilimin e Llogarive Kombëtare Sektoriale, vlerësimi i Ekonomisë jo Formale, etj. Gjithashtu në kuadër të fushës së Llogarive Kombëtare gjatë periudhës raportuese është realizuar procesi në revidimin e të dhënave të Bruto Produktit Vendor (BPV) në baza tremujore dhe vjetore të cilat kanë përfunduar ne Shtator 2021. Po ashtu është punuar në përpilimin e Llogarive Kombëtare përmes tabelave SUT të cilat vazhdojnë të përpilohen në një interval kohor më të gjatë deri në publikimin e tyre final.

Rendësi e veçantë i është kushtuar procesit të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë, pas Hartës Rrugore dhe Planit të aktiviteteve në aspektin kohor gjatë vitit 2021 është përgatitur edhe draft Ligji për Regjistrimin e Popullsisë.

Lidhur me proceset statistikore, Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vazhduar me hulumtimin dhe aplikimin e mënyrave dhe metodave për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në procesin e mbledhjes së të dhënave për Statistikat Zyrtare. Janë përdorur metodat CAPI dhe CATI për anketa të veçanta, të cilat në mënyrë graduale kanë vazhduar të zgjerohen edhe në anketat tjera nga viti në vit, me qëllim të rritjes së sigurisë dhe shpejtësisë së mbledhjes së të dhënave, si dhe avancimit të proceseve statistikore në Sistemin Statistikor të Kosovës.

Në anën tjetër, matja e performancës përmes Sistemit Informativ për Matjen e Kohës (SIPK) për gjithë strukturën operative të ASK-së, duke filluar me performancën në nivel të zyrtarit, njësisë, departamentit e deri në nivel të ASK-së, është bërë një nga proceset e zakonshme në kuadër të procesit menaxhues të ASK-së.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, ASK-ja, duke u bazuar në vlerësimin e Sistemit Statistikor të Kosovës "Peer Review 2017", ka vazhduar me zbatimin e Planit të veprimit, i cili është, duke u monitoruar në vazhdimësi nga ASK-ja dhe Eurostat. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2021 është përgatitur raporti lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga plani i veprimit për intervalin kohor dhjetor 2020 deri me 30 dhjetor 2021 dhe i njëjti është dërguar në Eurostat në fillim të vitit 2022.

Bazuar në Kalendarin vjetor të publikimeve për vitin 2021, publikimet janë realizuar në masën 93% gjegjësisht nga 127 të planifikuara, 119 raporte statistikore janë realizuar, prej tyre 113 publikime në kohën e paraparë. Publikimet e realizuara, gjegjësisht rezultatet e publikimeve janë shpërndarë në formën online në faqen zyrtare të ASK-së, duke respektuar Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP) për paanshmëri dhe objektivitet në qasjen e të dhënave për të gjithë shfrytëzuesit.

Raporti është i strukturuar në atë formë përmes të cilit janë prezantuar kapituj të veçantë për fusha të ndryshme, duke analizuar gjendjen dinamike respektivisht performancën krahasuese të vitit raportues me një vit më parë. Matja e performancës në procesin organizativ prodhues ndikon mjaft pozitivisht në planet vjetore të punës në vitet vijuese. Andaj, raporti përveç informatave mbi zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme, matjes dhe fuqizimit të kornizës vlerësuese dhe monitoruese të performancës, gjithashtu ofron informata për numrin e publikimeve, titujt e publikimeve dhe frekuencat e publikimeve në nivel të ASK-së, si dhe fushave sektoriale që janë realizuar gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin paraprak. Publikimet dhe të gjitha raportet tjera janë të postuara në Web faqen zyrtare të ASK-së: <http://ask.rks-gov.net/>

1. PERFORMANCA E ASK-së

Disa nga zhvillimet më të rëndësishme në kuptimin e performancës gjatë vitit 2021, janë listuar si më poshtë:

- Rritja e nivelit të përputhshmërisë me EU Acquis, në fusha të caktuara statistikore (CoP);
- Shkurtimi i afateve kohore në publikimin e BPV në baza vjetore dhe tremujore;
- Shkurtimi i afateve kohore në publikimin e rezultateve të TIK në ekonomitë familjare
- Fillimi i hulumtimeve të reja statistikore, si : Llogaritë Kombëtare Regjionale, Llogaritë Sektoriale, MICS, ICT, Investimet, Vlerësimi i Ekonomisë Joformale, etj.;
- Rritja e vëllimit dhe cilësisë së të dhënave statistikore;
- Rritja e vëllimit të përshkrimit të produkteve statistikore - meta data për statistika zyrtare;
- Rritja e numrit apo vëllimit të të dhënave dërguar në Eurostat;
- Rritja e nivelit të përputh mërisë në fusha me prioritet të dhënave statistikore përmes sistemit SMIS+
- Rritja e numrit të raporteve të kualitetit (4 sosh);
- Rritja e kapaciteteve njerëzore, administrative dhe profesionale të ASK-së;
- Rritja dhe forcimi i rolit të ASK-së në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës;
- Zbatimi dhe monitorimi i proceseve në kuadër të strategjive në nivel vendi, si PKZMSA, ERA, PVPQ, etj.;
- Zbatimi i rekomandimeve nga raporti “Peer Review për intervalin kohor: Dhjetor 2020-Dhjetor 2021”;
- Roli dhe kontributi i ASK-së në procesin OZHQ në Kosovë;
- Përgatitjet për Regjistrimin e Popullsisë (freskimi i Qarqeve Regjistruese, Projekt Propozimi i Përgatitur, Plani Financiar, etj.);
- Ligji për Regjistrimin e Popullsisë i aprovuar në Qeveri.
- Modernizimi i web faqes së ASK-së, me qasje të lehtë dhe shumë funksionale.
-

1.1. Korniza Ligjore dhe dokumentet bazë

Të drejtat, detyrimet si dhe fushat e përgjegjësisë në prodhimin e Statistikave Zyrtare për ASK-në, dhe për anëtarët e tjerë të Sistemit Statistikor të Republikës së Kosovës, janë të rregulluara me Ligjin mbi Statistikat Zyrtare Nr. 04/L-036 dhe Ligjin Nr. 06/l-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe aktet tjera përkatëse nënligjore. Zhvillimi dhe dinamika e aktiviteteve statistikore në arenën ndërkombëtare është mjaft e lartë e cila pashmangshëm ndër vepron edhe në Sistemin Kombëtar statistikor të Kosovës. Në këtë rrafsh korniza ligjore është përcaktuesi minuesi kryesor i ndryshimeve brenda sistemit Statistikor. ASK, ka vazhduar me implementimin e aktiviteteve si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore të mëparshme.

Gjatë vitit 2021, ASK, në bashkëpunim me Institucionet tjera të Republikës së Kosovës, ka punuar në draft hartimin e Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave. Pas fazës së konsultimeve publike dhe përfshirjes të komenteve nga partnerë të ndryshëm, ASK, e ka proceduar në MFPT respektivisht në Qeveri për procedura të mëtejshme.

Në aspektin e direktivave, rregulloreve e metodologjive, ASK përdor dhe zbaton brenda kornizës së përgjithshme të Eurostat, parimet e Kodit të Statistikave Evropiane (CoP), e cila është e mbështetur (lejuar) në ligjin mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës e kjo e fundit në rregulloren Nr. 223/2009 mbi Statistikat Evropiane. Si rezultat apo qëllim është përafrimi me ACQUIS, gjegjësisht, përafrimit të Sistemit Statistikor të Kosovës, me atë të BE-së dhe fuqizimit të rolit koordinues të ASK-së brenda Sistemit Statistikor të Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese 2021, ASK ja, ka vazhduar me plotësimin e dy draft UA, me komente nga zyra ligjore e MFPT, si dhe me palë të tjera si OJQ me qëllim të kompletimit dhe të bërit më funksional. Draft udhëzimet Administrative janë:

- a) Udhëzimin Administrativ për Konfidencialitetin e Statistikave dhe
- b) Udhëzimi Administrativ për Shitjen e të Dhënave Statistikore të cilat tani më janë në MFPT.

Bazuar në përgjegjësitë ligjore dhe Programin afatmesëm të Statistikave Zyrtare 2018-2022 të Punës, Agjendën Evropiane si dhe në Programin Vjetor të Punës së Qeverisë, gjatë vitit 2021, janë hartuar dhe realizuar dokumente mjaft të rëndësishme për ASK- në, si në vijim; Plani Vjetor i Punës për vitin 2022, si instrument për zbatimin e Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare 2018-2022; është bërë freskimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (pjesa e statistikave) 2021-2025; Raporti mbi Zbatimin e Rekomandimeve nga procesi “Peer Review 2017” për vitin 2021, Harta Rrugore 2022 në nivel të ASK-së, Draft Ligji për Regjistrimin të Popullsisë dhe Draft Buxheti, Raporti Vjetor i punës për vitin 2020, Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë (pjesa e ASK-së), Raportet e Monitorimit të PKZMSA-së në fushën e statistikave si dhe raporte të tjera të dërguara në Eurostat dhe Organizata tjera (SMIS+), pyetësorë me të dhëna, gjegjësisht vala e parë dhe vala e dytë, etj.)

Ministria e Arsimit dhe Shkencës me mbështetjen e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë gjatë vitit 2021 ka zhvilluar hartëzimin e kualifikimeve të sistemit arsimor të Kosovës me ISCED 11, dhe profilizimin e fushave të arsimit të mesëm profesional / teknik me ISCED-F 13. Ky proces do të mundësojë krahasimin e rezultateve të arsimit dhe treguesve arsimor me të gjithë shtetet tjera dhe përshtatjen e programeve arsimore në një kategori të krahasueshme ndërkombëtare. Konceptet dhe përkufizimet themelore të ISCED synojnë të jenë të vlefshme dhe të krahasueshme me ato ndërkombëtare. Implementimi i ISCED 2011 dhe ISCED –F 2013 pritet që të filloj gjatë vitit 2022 dhe do t'i mundësojë ASK-së që të filloj të raportoj të dhënat e arsimit në Eurostat.

Realizimi i kësaj nomenklature do të ndikoj në përafrimin e Statistikave Zyrtare me ACQUIS.

1.2. Këshilli Statistikor

Këshilli përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Krye shefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë institucionet kyçe, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile.

Gjatë vitit 2021, Këshilli Statistikor, ka mbajtur 4 takime sipas rregullores së brendshme për funksionim. Vlen të theksohet se në mbledhjen e mbajtur Prill 2021, këshilli ka formuar trupin koordinues për hartimin e listës së kritereve për statistika zyrtare. Gjithashtu në përputhje me ligjin mbi statistikat zyrtare, këshilli ka përgatitur dhe dërguar raportin e punës së këshillit në Ministrinë Financave, Punës dhe transfereve. Përveç tjerash, Këshilli Statistikor sipas Rregullores për funksionimin e tij, ka dhënë rekomandime lidhur me proceset e zhvillimit të Statistikave Zyrtare. Takimet e rregullta mbahen çdo tre muaj.

1.3. Bashkëpunimi dhe Komunikimi

ASK, edhe gjatë vitit 2021, ka vazhduar me zhvillimin dhe rritjen e bashkëpunimit në fusha të ndryshme statistikore me partnerë vendor dhe ndërkombëtar. Edhe përkundër rrethanave të krijuara nga situata e pandemisë, COVID 19, ASK, ishte angazhuar për shtrirjen e bashkëpunimit qoftë me partnerë të brendshëm si në aspektin e angazhimit të stafit në mbledhjen e të dhënave po ashtu edhe në aspektin e koordinimit ndërinstitucional. ASK dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, kanë arritur një marrëveshje për

angazhimin e stafit të regjistruar si punëkërkuar në Agjencinë e Punësimit. Kjo ka ndikuar në dinamikën e mbledhjes së të dhënave nga tereni pasi që situata ishte vështirësuar nga mungesa e një OE për mbledhjen të dhënave. Në anën tjetër me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes të vendeve të rajonit, ASK ka nënshkruar MeM me Institutin e Statistikave të Republikës së Shqipërisë INSTAT dhe Zyrën e Statistikave të Republikës së Maqedonisë së veriut. Po ashtu është nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me projektin regional SIDA për angazhimin e stafit në mes të vendeve të rajonit varësisht nga përparësitë teknike profesionale në fushat përkatëse.

Përveç shtrirjes së bashkëpunimit me vendet rajonit, ASK edhe gjatë vitit 2021, ka vazhduar fuqizimin e bashkëpunimit me Zyrën e Statistikave të vendeve Evropiane të BE respektivisht Eurostat. Si në çdo vit tjetër edhe në këtë vit raportues, Kosova respektivisht Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka arritur të realizojë një numër të konsiderueshëm të projekteve statistikore në kuadër të programit shumë përfitues IPA 2017 me qëllim të ngritjes së kapaciteteve tekniko profesionale të ASK-së, përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit përmes formës virtuale si takime, konsultime, ofrim i ekspertizës etj. (në aspektin shumëdimensional), vizita studimore, punëtori, takime në grup, etj.

Përkrahja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e Statistikave Zyrtare vazhdon të jetë i gjithanshëm, duke mbuluar pothuajse të gjitha fushat e Statistikave Sektoriale dhe më gjerë (ngritje e kapaciteteve përmes Pilot Projekteve, Trajnimeve, IT). Rritja e prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së Statistikave Zyrtare është një ndër objektivat kryesore të ASK-së, të cilat përkojnë edhe me Strategjinë e Programit shumë përfitues të Komisionit Evropian, gjegjësisht Eurostatit për rritjen e përputhshmërisë së Statistikave Zyrtare me ACQUIS.

Në nivel operativ zbatimi dhe përafrimi i metodologjive dhe standardeve ndërkombëtare në publikimin e statistikave zyrtare në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës paraqet boshtin e bashkëpunimit në mes të ASK së dhe Institucioneve Ndërkombëtare me theks të veçantë Eurostat-tin.

Përveç qëllimit në vetë fuqizim dhe përafrimi i Sistemit Statistikor të Kosovës me të Vendeve të BE-së, respektivisht rritje e nivelit të përputhshmërisë, fushat tjera sektoriale të cilat gëzojnë përkrahje të vazhdueshme janë: statistikave Makro-ekonomike, siç janë Llogaritë Kombëtare, përfshirë BPV, Statistikat e Çmimeve, Statistikat e Financave Qeveritare, Paritetit të Fuqisë Blerëse, Ekonomia Joformale, etj. Ndërsa në fushën e Statistikave Sociale, Statistikat e Tregut të Punës, Statistikat në të Ardhurat dhe Kushtet e Jetës (SILC), Statistikat e Arsimit, Statistikat e Popullsisë, Anketa për Teknologjinë Informativë (ICT) etj. Në fushën e Statistikave të Biznesit i është kushtuar vëmendje Anketës Strukturore të Bizneseve, Statistikave Afatshkurtra, Statistikave të Energjisë, Transportit, etj. Në fushën e Statistikave të Bujqësisë, në fokus të bashkëpunimit kanë qenë Llogaritë Ekonomike për Bujqësi, Statistikat e Kulturave Bujqësore Bimore, Statistikat e Blegtorisë dhe Prodhimeve Blegtoriale. Jo më pak rëndësi i është kushtuar edhe Statistikave të Tregtisë Ndërkombëtare, Statistikat e TIK (ICT) në nivel të Bizneseve, pasuar me Regjistrat Statistikor, si Regjistri i Bizneseve, Regjistri i Bujqësisë, Llogaritjeve mjedisore, etj.

Në rrafshin e brendshëm, nga viti në vit, përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me Institucionet e tjera, ASK-ja ka siguruar qasje dhe lehtësim në burimet administrative të të dhënave. Kjo ka mundësuar ngritjen e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës dhe krahasueshmërinë me statistikave të vendeve tjera të rajonit dhe më gjerë. Gjatë vitit 2021, janë nënshkruar disa marrëveshje të mirëkuptimit me Institucione vendore dhe ndërkombëtare si MeM ASK-Instat (Republika e Shqipërisë), ASK-Zyra e Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, MeM , ASK-SIDA në kuadër të projektit regional si dhe MeM e nënshkruar në mes të ASK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës.

Komunikimi – Komunikimi me shfrytëzuesit e Statistikave Zyrtare konsiderohet si një ndër veglat më të rëndësishme në aspektin e orientimit në procesin prodhues të Statistikave Zyrtare dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kualitetit të tyre. ASK-ja ka krijuar formën elektronike përmes formularit elektronik në ueb-faqe e ASK-së për kërkesat e tyre, si dhe për media si dhe vazhdon ta mirëmbaj këtë formë komunikimi në

mënyrë që shfrytëzuesit të jenë të furnizuar me të dhëna statistikore dhe përmirësim të kualitetit të tyre. Po ashtu, i është kushtuar kujdes i veçantë popullimit me informata të reja të përmbajtjes së ueb-faqes së ASK-së, dhe mediave sociale (Facebook). Sa i përket numri të personave që përcjellin faqen zyrtare në rrjetet sociale facebook, Kosova respektivisht ASK renditet me numrin me të madh të ndjekëseve nëse marrim për bazë numrin e banorëve në vendet e rajonit tonë. Me gjithë sfidat që janë paraqitur kohë pas kohe, përdoruesit e Statistikave Zyrtare, në mënyrë të vazhdueshme, janë informuar për të dhënat më të fundit statistikore, duke shtuar edhe publikimet mujore. Në anën tjetër, komunikimi me media ka vazhduar rrjedhën e bashkëpunimit të mirëfilltë, duke rritur kontaktet me gazetarë, si dhe duke rritur numrin e intervistave në media, ku paraqitjet stafit të ASK-së në TV dhe Radio është rritur. Kontaktet me përdorues (qofshin institucione publike, universitete publike a private, organizata vendore a ndërkombëtare, ose individë), kanë vazhduar duke shfrytëzuar instrumente dhe metoda të ndryshme, qoftë përmes platformave elektronike, adresës zyrtare me shkrim, intervistave përmes telefonit, xhirimeve me kamerë, dhe përmes mediave sociale.

Monitorimi është bërë përmes platformës “Google Analytics”, andaj në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak, numri i vizitorëve ka shënuar rënie nga 115,830 në vitin 2020 ne 94121 ne vitin 2021.


Rritja dhe zhvillimi i ueb-it dhe teknologjisë së ndërlidhur ka ndryshuar mënyrën, që përdoruesit presin për t'u qasur në Statistikat Zyrtare. ASK në vazhdimësi është duke punuar në mënyrë që të dhënat zyrtare të statistikave të jenë sa më lehtë të qasshme dhe të kapshme për të gjithë shfrytëzuesit. Në vijim përmes formës tabelore janë paraqitur numri i vizitorëve në faqen zyrtare të saj sipas muajve të kalendarik të vitit.

Tab. 1: Numri i vizitoreve, 2018-2021


Muajt	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Janar	6357	8219	12258	9173
Shkurt	8472	6285	11295	9861
Mars	6701	7305	10013	9638
Prill	7675	9393	12817	9405
Maj	6790	8886	9098	7437
Qershor	5973	7357	9220	8183
Korrik	5195	8593	8408	6926
Gusht	9268	7203	8009	7571
Shtator	10837	8445	7705	9269
Tetor	11603	9375	8204	10800
Nëntor	7842	8175	9541	9863
Dhjetor	7505	9705	9262	9475
Gjithsej	94218	98941	115830	94121

Të dhënat e formës tabelore për vitet 2020-2021 janë të prezantuara edhe përmes formës grafike si më poshtë:

Graf.1: Numri i vizitoreve, 2020-2021




Graf. 2: Prania e ASK-së në media dhe përgjigjet ndaj përdoruesve të Statistikave Zyrtare 2015-2021



Edhe gjatë vitit 2021, ASK-ja ka bërë përpjekje të vazhdueshme që ta ruajë komunikimin me publikun dhe bashkëpunimin me përdoruesit e statistikave zyrtare. Një hap më tej për ta bërë komunikimin më të lehtë me përdorues, ASK-ja ka krijuar formën elektronike përmes formularit elektronik në ueb-faqe e ASK-së për kërkesat e tyre, si dhe për media. Po ashtu, i është kushtuar kujdes i veçantë popullimit me informata të reja të përmbajtjes së ueb-faqes së ASK-së, dhe mediave sociale (Facebook). Me gjithë sfidat që janë paraqitur kohë pas kohe, përdoruesit e statistikave zyrtare, në mënyrë të vazhdueshme, janë informuar për të dhënat më të fundit statistikore, duke shtuar edhe publikimet mujore. Në anën tjetër, komunikimi me media ka vazhduar rrjedhën e bashkëpunimit të mirëfilltë, duke rritur kontaktet me gazetarë, si dhe duke rritur numrin e intervistave në media, ku paraqitjet stafit të ASK-së në TV dhe Radio është rritur. Kontaktet me përdorues (qofshin institucione publike, universitete publike a private, organizata vendore a ndërkombëtare, ose individë), kanë vazhduar duke shfrytëzuar instrumente dhe metoda të ndryshme, qoftë përmes platformave elektronike, adresës zyrtare me shkrim, intervistave përmes telefonit, xhirimeve me kamerë, dhe përmes mediave sociale.

Monitorimi i mediave edhe gjatë vitit 2021 është bërë në baza ditore. Janë evidentuar: 429 shkrime që kishin të bënin me ASK-në, kryesisht në media elektronike. Ndërkaq, nga 44 kërkesave janë realizuar 37 prononcime në media (paraqitje në TV/radio). Kurse, nga kërkesat e regjistruara nga përdoruesit e statistikave zyrtare, gjatë vitit 2021, ASK-ja ka pranuar 567 kërkesa, ku prej tyre, ka arritur t'u jep përgjigje në 413 sosh.

Graf. 3: Monitorimi i ndjekësve në Facebook



1.4. Llogaritë Kombëtare

Edhe pse gjatë vitit 2021, kishte sfida për shkak të COVID -19, megjithatë këtë vit është shënuar progres i dukshëm në zbatimin e metodologjisë së Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010, në bazë të së cilës është bërë edhe publikimi i Statistikave të Llogarive Kombëtare. Të gjitha publikimet janë kryer me kohë sipas Planit dhe Kalendarit të Publikimeve.

Janë rishikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor (BPV) me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe çmime të vitit të kaluar (në baza vjetore 2008-2019); Janë integruar të dhënat e ekonomisë jo-formale; Janë rishikuar të dhënat në baza tremujore TM1/2010-TM4/2020 (të gjitha të dhënat janë transmetua në Eurostat).

Gjatë periudhës referuese në fushën e statistikave të llogarive kombëtare janë publikuar:

Në baza tremujore janë publikuar:

- Bruto Produkti Vendor (BPV), me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, për tremujorët (TM4/2020- TM3/2021);

Në baza vjetore është publikuar:

- Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit për vitin 2020.

Aktivitete tjera të realizuara:

- **Është rritur numri i tabelave** me të dhëna në Eurostat në krahasim me vitin paraprak (numri i tabelave është për 8 tabela më shumë), të dërguara në Eurostat përmes platformës SDMX-RI.
- **Afati kohor** i publikimit të të dhënave të Bruto Produktit Vendor në baza tremujore është shkurtua në T+75 ditë, duke filluar nga TM1/2021 (të dhënat janë dërgua në Eurostat);
- Janë përllogaritë dhe dërguar të dhënat e BPV-së, në baza tremujore sipas lidhjeve zingjirore dhe efekteve se zonale;
- Është bërë, përllogaritja e Bruto Produktit Vendor (eksperimentale) sipas qasjes së të ardhurave (të dhënat janë transmetua në Eurostat),
- Vlerësimi i shpenzimeve të konsumit final të ekonomive familjare sipas qëndrueshmërisë, me çmime aktuale;
- Kalkulimi i treguesve makro; Përpilimi i Llogarive sektoriale jo- financiare vjetore (tabela 8 e transmetuar); Është përditësuar “Përshkrimi i burimeve dhe metodave të Llogarive sektoriale jo-financiare vjetore”; Përpilimi i Llogarive Rajonale-eksperimentale (Tabela 10 e transmetuar); Përllogaritja e BPV-se sipas Tabelave Ofruese-Përdoruese (SUT)-tabelat 15 dhe 16 janë transmetua;
- Janë përditësua metadatat e Llogarive Kombëtare. Të gjitha të dhënat janë transmetua përmes platformës SDMX-RI.

Pas rishikimit të të dhënave të BPV në baza vjetore dhe tremujore, është përditësuar në tërësi “Përshkrimi i burimeve dhe metodave të përdorura tek Llogaritë Kombëtare vjetore me çmime aktuale (pjesa A)”, pjesa B (me çmime konstante), si dhe “Përshkrimi i burimeve dhe metodave të përdorura tek Llogaritë Kombëtare tremujore me çmime aktuale dhe konstante”. Në këtë dokument, është shtuar edhe kapitulli i shtatë (vlerësimet e ekonomisë jo-formale).

Janë kryer me sukses 6 projekte të IPA 2017 (të gjitha të dhënat dhe raportet janë pranua nga Eurostat-i).

Në kuadër të **statistikave të Llogarive Qeveritare dhe Ekonomisë Joformale** janë realizuar sipas Planit të Punës të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin 2021 dhe është shënuar progres i dukshëm për aktivitetet e mëposhtme.

Lidhur me **Statistikat e Llogarive Qeveritare**, gjatë kësaj periudhe janë publikuar:

Në baza tremujore:

- Llogaritë Qeveritare TM4 2020-TM3 2021

Në baza vjetore janë publikuar:

- Llogaritë Qeveritare për vitin 2020

Ka vazhduar **zbatimi i metodologjisë ESA 2010 për Statistikat e Llogarive Qeveritare:**

- Përpilimi i tabelave 1, 2 dhe 3 të EDP-së (Excessive deficit procedure) dhe dërgimi në Eurostat;
- Përgatitja e inventarit të metodave, procedurave dhe burimeve të përdorura për përpilimin e të dhënave të deficitit dhe borxhit dhe të Llogarive Qeveritare sipas ESA 2010
- Përgatitja e tabelave të njoftimit për EDP dhe dërgimi në Eurostat

Përpilimi i **tabelave për financat e Llogarive Qeveritare** dhe dërgimi në Eurostat:

- Tabela ESA 0200 - Agregatet kryesorë të Qeverisë së përgjithshme
- Tabela ESA 0900 - Tatimet e detajuara dhe kontributet sociale sipas llojit të tatimit
- Tabela ESA 1100 - Shpenzimet e Qeverisë së përgjithshme sipas funksioneve
- Tabela ESA 2500 - Llogaritë jo financiare tremujore për Qeverinë e Përgjithshme
- NTL - Lista e detajuar e taksave dhe kontributeve sociale sipas klasifikimit kombëtar

Ndërsa, në mënyrë që të sigurohet mbulues mëri e plotë e Llogarive Kombëtare, gjatë vitit 2021 është shënuar progres i dukshëm lidhur me Statistikat e Ekonomisë Joformale, duke përfshirë:

- Integrimi i të dhënave të Ekonomisë Joformale për herë të parë në të dhënat e rishikuara të Llogarive kombëtare dhe publikimi i tyre për aktivitetet ekonomike NACE rev.2: 49-Transporti tokësor, 55-Akomodimi dhe 56-Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve. Të dhënat janë publikuar në baza vjetore për periudhën 2008-2019, me çmime aktuale dhe konstante;

Agjencia e Statistikave të Kosovës, për herë të parë gjatë vitit 2021 i ka integruar të dhënat e Ekonomisë joformale në të dhënat e rishikuara të Llogarive kombëtare dhe i ka publikuar ato për tri aktivitete ekonomike sipas NACE rev.2: 49-Transporti tokësor, 55-Akomodimi dhe 56-Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve. Të dhënat janë publikuar për periudhën 2008-2019 në baza vjetore, me çmime aktuale dhe konstante. Gjatë vitit 2021 po ashtu është zbatuar metodologjia e Eurostatit dhe OECD-së për vlerësimin e ekonomisë joformale bazuar në Metodën e In putit të Punës (Labor In put Method), metodologjia për vlerësimin e ekonomisë joformale bazuar në kontrollet e auditimit fiskal dhe metodologjia për vlerësimin e aktiviteteve ilegale: trafikimin e drogës në Kosovë.

- Zbatimi i vazhdueshëm i metodologjisë së Eurostatit dhe OECD-së për vlerësimin e ekonomisë joformale sipas aktiviteteve ekonomike dhe tipave të ekonomisë joformale;
- Përpilimi i të dhënave për ekonominë joformale për aktivitetet ekonomike: transport tokësor, restorante, hotele dhe ndërtimtari në përputhje me metodologjinë ndërkombëtare, në baza vjetore dhe tremujore, me çmime aktuale dhe konstante;

- Implementimi i metodologjisë ndërkombëtare për vlerësimin e Ekonomisë Joformale bazuar në kontrollet e auditimit fiskal;
- Implementimi i metodologjisë ndërkombëtare për vlerësimin e Ekonomisë Joformale bazuar në Metodën e In putit të Punës (LIM);
- Implementimi i metodologjisë ndërkombëtare për vlerësimin e aktiviteteve ilegale: trafikimin e drogës;
- Dokumentimi i proceseve statistikore/përgatitja e raporteve metodologjike me përshkrimin e metodave dhe burimeve të përdorura për përpilimin e të dhënave të Ekonomisë Joformale për të gjitha komponentët e mësipërme;
- Hulumtimi i ekonomisë joformale për aktivitete të caktuara, siç janë shëndetësia, bujqësia, hoteleria; rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional, etj.

Siç është cekur më lartë bashkëpunimi me partnerë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021 përmes platformës virtuale, përveç në fusha tjera edhe në fushën e Llogarive Kombëtare, projekti EU/SIDA ka ndihmuar në përmirësimin e Llogarive Kombëtare dhe Ekonominë Joformale.

1.5. Statistikat Ekonomike

Gjatë vitit 2021 në fushën e Statistikave Ekonomike janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara, sipas planit dhe dinamikës së paraparë. Gjatë kësaj periudhe përkundër rrethanave të krijuara për shkak të Pandemisë COVID 19, ka pasur stabilitet në numrin e produkteve statistikore dhe shkurtim të afateve kohore të publikimeve.

Në kuadër të Statistikave të Hotelarisë dhe Turizmit TM4 janë publikuar të dhënat mbi qarkullimin turistik (hyrjet dhe daljet e njerëzve) në pikë-kalimet kufitare për vitin 2020. Gjatë vitit 2021, po ashtu janë transmetuar në Eurostat të dhënat për statistikën e Lejeve të Ndërtimit në baza tremujore. Për të gjitha produktet statistikore ka vazhduar shkurtimi i afateve kohore të publikimit.

Në Sektorin e Çmimeve janë publikuar:

- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, në baza mujore dhe vjetore,
- Indeksi i Çmimeve të Importit,
- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe
- Indeksi i Kostos së Ndërtimit, në baza tremujore.

Të dhënat e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit janë transmetuar në baza mujore në Eurostat në platformën SDMX, gjithashtu transmetohet në baza të rregullta mujore në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) në GDDS (General Data Dissemination System), kurse Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në baza tremujore transmetohet në FMN.

Në baza të rregullta mujore gjatë vitit 2021 janë publikuar:

- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për periudhat dhjetor 2020 deri nëntor 2021, ndërsa në baza vjetore është publikuar IHÇK me vit referues 2020;
- Është publikuar Inventari (përshkrimi metodologjik i standardizuar) i IHÇK-së me të dhënat e vitit 2020. Ky publikim është publikuar vetëm në gjuhën angleze;
- Është realizuar Anketa e Qirasë në muajin qershor 2021.

Në baza tremujore për periudhën TM4/2020 - TM3/2021, janë publikuar:

- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP),
- Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP) dhe
- Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN).

Mbështetur nga IPA MB 2017 është vazhduar me Projektin e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB), që është në kuadër të Programit të Krahasueshme risë Evropiane (ECP).

Në fushën e **Statistikave të Bizneseve dhe të Tregtisë së Jashtme**, janë realizuar publikimet sipas titujve të ndryshëm në baza mujore, tremujore dhe vjetore.

Në baza mujore janë publikuar:

- Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) për periudhën dhjetor 2020-nëntor 2021;

Në baza tremujore janë publikuar:

- Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike,
- Statistikat e Transportit,
- Statistikat e Hotelerisë,
- Bilanci i Energjisë,
- Statistikat e Industrisë bashkë me Indeks të Vëllimit Industrial dhe
- Statistikat e Tregtisë me Pakicë, për periudhën (TM4/2020 - TM3/2021).

Në baza vjetore janë publikuar:

- Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (2020),
- Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it (2020),
- Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) (2020),
- Bilanci i Energjisë në Kosovë (2020)
- Rezultatet e Anketës për Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe Komunikim në Ndërmarrje (ICT) 2020 dhe
- Rezultatet e Anketës së Investimeve në Ndërmarrje (2020).

Gjatë vitit 2021 është kryer "Anketa për Përditësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve" me të dhëna mbi llojin e njësisë sipas aktiviteteve ekonomike". Kjo anketë realizohet me qëllim të ngritjes së cilësisë së Statistikave Ekonomike përmbushjes së kërkesave për zbatimin e rregullore të BE-së për Statistika të Ndërmarrjeve, projekteve tjera si të Llogaritë Kombëtare për prodhimin e BPV regional dhe statistikave tjera që shfrytëzojnë Regjistrin Statistikor të Bizneseve në përgjithësi.

Në tërësi, në fushën e Statistikave Ekonomike janë publikuar gjithsej 66 raporte statistikore në përputhje me kalendarin e publikimeve.

Për shkak të Pandemisë Covid-19, gjatë vitit 2021 ka pasur një rritje të shfrytëzimit të të dhënave administrative për publikimin e Statistikave Ekonomike.

1.6. Statistikat Sociale

Edhe përkundër vështirësive me situatën COVID -19 dhe mbylljes të përgjithshme për një kohë të caktuar megjithatë si në fushat tjera edhe në fushën e Statistikave Sociale janë realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet e planifikuara me Planin e Punës për vitin 2021. Gjatë periudhës raportuese është shënuar progres i lehtë në shkurtimin e afateve kohore tek disa publikimeve si dhe në ngritjen e cilësisë së të dhënave.

Në kuadër të Statistikave të Popullsisë duke u bazuar në burime administrative nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) janë publikuar:

- Statistikat e Lindjeve 2020;
- Statistikat e Vdekjeve 2020;
- Vlerësimi i Popullsisë 2020;
- Statistikat e Kurorëzimeve 2020
- Statistikat e Shkurorëzimeve 2020;

Gjithashtu gjatë vitit 2021, ASK, ka bërë një lëvizje në aspektin e afateve kohore duke kaluar me publikimin e të dhënave vitale (lindje, vdekje, kurorëzime dhe shkurorëzime) në baza mujore duke u bazuar në të dhëna administrative (ARC).

Në baza tremujore janë publikuar:

- Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM4/2020 –dhe TM1/2021;
- Statistikat e Mirëqenies Sociale për TM4/2020 - TM3/2021.

Në baza vjetore janë publikuar:

- Rezultatet e Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative (TIK) 2021;
- Rezultatet e AFP 2020;
- Statistikat e Arsimit 2020/2021;
- Niveli i Pagave në Kosovë 2020;
- Statistikat e Kulturës 2020;
- Statistikat e Shëndetësisë 2020

Gjatë vitit 2021 është bërë grumbullimi i të dhënave për Statistikat e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve dhe Statistikat e Shkurorëzimeve me referencë vitin 2021.

Situata me Pandeminë COVID -19 ka bërë që publikim i **Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC) 2019 dhe 2020** nuk ka mundur të realizohet gjatë vitit 2021, për shkak të mungesës së ekspertizës kombëtare. Në anën tjetër, për shkak të ndikimit të Pandemisë COVID-19 ku herë pas here ka pasur ndërprerje të grumbullimit të dhënave të AFP-së gjatë vitit 2021 publikimet e AFP për TM2 dhe TM3/ 2021 nuk kanë mundur të realizohen gjatë vitit 2021.

Publikimi i **Statistikave të jurisprudencës për Persona të Mitur dhe Persona madhor** për vitin 2020 nuk është realizuar pasi që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) përkatësisht Departamenti i Statistikave pranë KGJK si burim i të dhënave nuk ka arritur që t'i dërgoj të dhënat në ASK meqë janë në proces të finalizimit të modulit të statistikave të avancuara në kuadër të implementimit të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL).

Publikimi i **Statistikave të Sportit për vitin 2020** nuk është publikuar për shkak se Federatat e Sporteve nuk i kanë raportuar të dhënat, edhe pse ASK-ja ka bërë përpjekje të vazhdueshme për grumbullimin e tyre.

Regjistrimi i Popullsisë- Në kuadër të parapërgatitjeve për **Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2022**, janë realizuar një sërë aktivitetesh, si: hartimi i Draft Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë 2022, Plani i aktiviteteve si dhe projekt bugjeti, etj.

Në kuadër të Projekteve Statistikore mbështetur nga IPA 2017- ka filluar zhvillimi i anketës **Dhuna në baza gjinore**. Ky aktivitet është përkrahur nga Komisioni Evropian si prioritet dhe si rrjedhojë ka mbështetur zhvillimin e kësaj ankete me mjete financiare me qëllim të sigurimit të të dhënave dhe krahasueshme-rinë tyre në nivel ndërkombëtar. Kjo anketë është duke u zhvilluar për herë të parë edhe në Kosovë në ekonomi familjare.

1.7. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit

Në fushën e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe raportuese, është evidentuar progres në shkurtimin e afateve kohore të publikimeve, si dhe në përmirësimin e cilësisë dhe në harmonizimin me metodologjitë e Eurostatit, sidomos në prodhimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve dhe in puteve në Bujqësi, me vitin bazë 2015=100.

Gjatë periudhës raportuese është bërë grumbullimi i të dhënave në terren dhe monitorimi i zhvillimit të Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB), si dhe është bërë kontrollimi i cilësisë së grumbullimit të të dhënave të kësaj ankete. AEB 2021 është kryer me metodën “CAPI” duke i shfrytëzuar tabletat. Kjo metodë përveç ndikimit në rritjen e cilësisë, gjithashtu është modernizim i procesit të grumbullimit të të dhënave dhe ka mundësuar që të dhënat e AEB 2020 të jenë në dispozicion për përpunim dhe analiza në kohë më të shkurtë duke eliminuar fazat tjera si kohën e përfshirjes së të dhënave në kompjuter siç ishte me pyetësorët në letër (metoda PAPI) dhe ka kosto më të lirë. Të dhënat janë mbledhur nga anketuesit e kontraktuar sipas marrëveshjes së ASK-së dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) që është në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Në kuadër të Statistikave të Bujqësisë janë publikuar rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) 2020.

Ndërsa tek Statistikat Agro-monetare, në baza tremujore janë publikuar:

- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi (TM4/2020 dhe TM1-TM3/2021) si dhe Indeksi i Çmimeve të in puteve në Bujqësi (TM4/2020 dhe TM1-TM3/2021 me vitin bazë 2015 = 100.

Në baza vjetore janë publikuar:

- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi 2015 - 2020,
- Indeksi i Çmimeve të in puteve në Bujqësi 2015 - 2020 dhe
- Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2020.

Të gjitha publikimet mbi Indeksit e Çmimeve të Prodhimeve dhe In puteve në Bujqësi gjatë vitit 2021, janë publikuar me vitin bazë 2015=100 dhe është bërë monitorimi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe përpunimi i tyre.

Në Statistikat e Mjedisit janë publikuar:

- Anketa e Mbeturinave Komunale 2020;
- Anketa e Mbeturinave Industriale 2020;
- Disa Fakte për Mjedisin 2019 -2020 dhe
- Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2020.

Janë grumbulluar të dhëna nga burimet administrative për Statistikat e Ujërave, Statistikat e Ajrit, Fakte mbi Mjedisin dhe për Statistikat tjera të Bujqësisë dhe Mjedisit.

Në kuadër të përkrahjes së asistencës teknike (IPA 2017) nga Eurostat-ti, janë kryer disa aktivitete përdy Pilot Projekte, gjegjësisht për: Statistikat e Bujqësisë (Kulturat Bujqësore vjetore dhe Kulturat e Përhershme Bimore (Pemët dhe Vreshtat); Statistikat e Prodhimtarisë Blegtorale (Statistikat mujore dhe vjetore mbi Therjet e Kafshëve, Statistikat mujore dhe vjetore mbi Prodhimin e Qumështit); Anketa mbi Strukturën e Fermave, Statistikat Agromonetare (Llogaritë Ekonomike për Bujqësi, Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve në Bujqësi), dhe Llogaritjet Mjedisore (Emisionet e Ajrit dhe llogaritjet tjera mjedisore).

Me theks të veçantë në kuadër të ndihmës nga Eurostat, përmes Pilot Projektit (MB IPA 2017), ASK ka përgatitur Hartën Rrugore për Statistikat e Bujqësisë për periudhën 2020-2023.

Lidhur me aplikimin e metodologjisë, si në fushat tjera sektoriale edhe në prodhimin e Statistikave të Bujqësisë, Agromonetare dhe të Mjedisit, ASK ka zbatuar rregulloret, metodat dhe udhëzimet sipas standardeve të Organizatave Ndërkombëtare, në veçanti ato të Eurostatit.

Në fushën e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, gjatë vitit 2021 janë publikuar gjithsej 16 publikime (raporte statistikore) tremujore dhe vjetore.

1.8. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare

Përkrahja e Eurostat-it, për ASK-në, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021 me projekte statistikore në fusha të ndryshme statistikore. Qëllimi i këtyre Pilot Projekteve është ngritja e kapaciteteve të stafit, me qëllim të rritjes së numrit të indikatorëve (të dhënave të reja) dhe përmirësimi i cilësisë së atyre ekzistuese.

Në vijim janë paraqitur titujt e Projekteve Statistikore të realizuara gjatë vitit 2021, të mbështetura nga Komisioni Evropian, në kuadër të programit IPA MB 2017.

Titujt e Projekteve Statistikore në kuadër të IPA MB 2017:

Nr. r	Përshkrimi
1. 1.1.	Statistikat e Financave të Qeverisë dhe Deficitit të Tepërt
2. 1.2.	Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Shërbimeve (ITSS)
3. 1.3.	Llogaritë Kombëtare - Metodologjia
4. 1.4.	Programi i Transmetimit, Llogaritë Kombëtare vjetore (LIKV), Llogaritë Kombëtare tremujore (LIKT)
5. 1.5.	Llogaritë Rajonale
6. 1.6.	Llogaritë e Sektorit
7. 1.7.	Tabelat e furnizimit, përdorimit dhe hyrje-daljet (TF/PHD)
8. 2.1.	Harmonizimi I Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe (HICK) dhe Indeksi i Çmimit të Shtëpisë (ICSh)
9. 2.2.	Statistikat e Çmimeve
10. 3.1.	Regjistrat e Biznesit
11. 3.2.	Statistikat afatshkurtra të Biznesit: përgatitja për FRIBS
12. 3.7.	Statistikat Strukturore të Biznesit (SSB) dhe Statistikat e Demografisë së Biznesit/BDB

13. 3.8. Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Mallrave (STNM)
14. 3.9. Statistikat e Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D) dhe Statistikat e GBAORD
15. 4.1. Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)
16. 4.2. Anketa e të Ardhurave (EU-SILC)
17. 4.4. Statistikat e Krimit dhe Drejtësisë Penale
18. 4.7. Anketa mbi Dhunën me Bazë Gjinore (DHBGJ);
19. 5.0. Statistikat e Bujqësisë
20. 5.5. Llogaritjet Mjedisore
21. 6.1. Menaxhimi i Cilësisë
22. 6.2. Meta data
23. 7.1. Të dhënat burimore (bazë) të nevojshme për llogaritjen e procedurës së disbalancave makroekonomike (MIP)
24. 8.1. Raportimi i Aktiviteteve Horizontale

1.9. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informativë

Gjatë periudhës raportuese bazuar në Planin Vjetor të Punës në kuadër të proceseve statistikore, në aspektin metodologjik janë përgatitur të gjitha mostrat e nevojshme si dhe llogaritja e peshave për anketat e realizuara statistikore. Gjithashtu Stafi i metodologjisë ka realizuar një sërë aktivitete lidhur me aspektet metodologjike dhe ato të cilësisë në fusha dhe aktivitete të ndryshme statistikore si : Anketa Dhuna në baza Gjinore (përzgjedhja e Qarqeve Regjistruese dhe ekonomive familjare), Anketën Post Regjistruese (APR), SILC etj.

Desiminimi Shpërndarja

Në baza tremujore gjatë periudhës raportuese janë realizuar dhe publikuar:

- Buletini Tremujor (TM4/2020, TM1, TM2 dhe TM3/2021), ndërsa në baza vjetore janë publikuar;
- Vjetari Statistikor 2021,
- Kosova në Shifra 2020,
- Katalogu i Publikimeve 2020 dhe
- Kalendari i Publikimeve për vitin 2022

Gjatë periudhës referuese ka vazhduar përgatitja dhe publikimi në Web faqe të ASK-së Kalendari vjetor i publikimeve i cili është monitoruar nga sektori i shpërndarjes, duke informuar shfrytëzuesit në kohë për të gjitha publikimet që do të publikohen si dhe duke informuar shfrytëzuesit me kohë për arsyesh mërinë e vonesës së publikimeve nëse ato nuk janë publikuar në afatin kohorë për të cilin kanë raportuar sektorët përgjegjës. Gjithashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi është bërë përkthimi në gjuhët zyrtare të gjitha publikimeve të dala nga ASK-ë, standardizimi, dhe pajisja me ISBN numër dhe katalog-imi i publikimeve vjetore për të gjitha publikimet e ASK-së.

Mes tjerash, gjatë vitit referues ASK, ka bërë ndryshimin e dizajnit të publikimeve si dhe ka arritur të realizoj Anketën e Kënaqshësisë së stafit dhe përgatitjen e raportit. Në baza të rezultateve të anketës është përgatitur lista e veprimeve.

Meta data dhe Cilësia

Me mbështetjen e IPA 2017, është zhvilluar aplikacioni i quajtur SIMS (Single Integrated Metadata Structure) Sistem për Ruajtjen, Menaxhimin dhe Integrimin e Meta datave sipas formateve ESQRS dhe ESMS. Përmes këtij sistemi meta datat do të janë të standardizuara dhe të qasshme nga përdoruesit. Ky aplikacion është zhvilluar sipas standardeve të Eurostat-it, ku përmes këtij sistemi baza e njëjtë përdoret për shpërndarjen e meta datave në Web faqe të ASK dhe të njëjtat mund të gjen erohen në formatin SDMX për transmetim e të dhënave në Eurostat përmes platformës së tyre Meta data Handler.

Është duke funksionuar bashkëpunimi profesional në mes të grupit punues të ASK-ës, Bankës Qendrore (BQ) dhe Ministrisë së Financave (MeF) për harmonizimin e Meta datave si dhe implementimin e aplikacionit SIMS. Sistemi i Meta datave është në zhvillim e sipër sipas standardeve të Eurostat dhe është duke u mbështetur nga Eurostatit përmes Pilot Projekteve.

ASK-ja, gjatë vitit 2021 ka përfunduar 4 raporte të cilësisë sipas ESQRS, si:

- Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (EU-SILC), 2018,
- Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi, 2020,
- Gazrat Serë, 2015,
- Llogaritë Qeveritare, 2019.
- Është bërë përgatitja e udhëzuesit për raportet e cilësisë për versionin SIMS 2.0.

Në kuadër te përkrahjes nga Eurostat (MBP IPA 2017) përmes Pilot Projektit “Menaxhimi i Cilësisë” është përgatitur dokumenti “Udhëzimet për zbatimin e GSBPM në ASK”. Gjithashtu është bërë përshkrimi i 3 produkteve në bazë të GSBPM-it:

- Anketa e Fuqisë Punëtore;
- Bilanci i Energjisë dhe
- Statistikat e Arsimit.

Në kuadër te Projektit është bërë adaptimi i pyetësorit për vetëvlerësim (Self-Assessment), pyetësori i cili është plotësuar nga Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore dhe Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve.

Teknologjia Informative dhe GIS


Krahasuar me një vit më parë, sektori i Teknologjisë Informative në ASK, ka shënuar progres në mënyrë të konsiderueshme, duke krijuar infrastrukturë të besueshme dhe pajisje adekuate të TI-së. Statistikat zyrtare të ASK-së publikohen në web faqen zyrtare të saj, të cilat janë dispozicion në mënyrë të integruar në platformën ASKdata .

Janë bërë përpjekje dhe angazhim maksimal lidhur me avancimin e proceseve statistikore dhe jo statistikore nga prizmi i teknologjisë informative në modernizimin dhe avancimin e tyre. procesi i mbledhjes, përpunimit dhe arkivimit të të dhënave ka kaluar në një stad tjetër krahasuar me vitet paraprake.

Modernizimi i mbledhjes së të dhënave

Vitet 2020-2021 karakterizohen si vite të avancimit të teknologjive dhe metodologjive të reja për grumbullimin e të dhënave përmes metodës CAPI dhe CAËI.

Kalimi nga PAPI në CAPI përfshin përdorimin e pyetësorëve elektronikë të administruara përmes pajisjeve të dorës Celularë apo Tabletë. Ndërsa kalimi nga PAPI në CAËI përfshin mbledhjen e të dhënave përmes një shfletuesi (browser) online.

Graf. 4: Metodatat e mbledhjes së të dhënave në ASK

Për herë të parë metoda CAPI është përdorur në Anketën e Fuqisë Punëtore 2012. Pastaj janë zhvilluar edhe anketa të tjera përmes këtyre teknologjive. Adoptimi i këtyre metodave CAPI dhe CAËI ka qenë i jo i lehtë duke pasur parasysh kapacitetet e limituara që ka ASK, pastaj për shkak të shqetësimeve për koston e pajisjeve dhe ekspertizës, riorganizimin e proceseve statistikore dhe trajnimin, cilësinë e teknologjisë, mungesën e lidhjes në internet të pajisjeve të dorës, kapacitetet njerëzore dhe rezistencën ndaj ndryshimeve. Sido çoftë, falë një angazhimi të përbashkët të të gjithë hisedarëve në ASK, shumica e anketa janë zhvilluar përmes metodës CAPI dhe CAËI.

ASK, fillimisht kishte filluar me zbatimin e këtyre metodave në mbledhjen e të dhënave për Anketën e Fuqisë Punëtore. ASK i dha prioritet këtyre teknologjive duke zgjeruar shtrirjen e këtyre metodave edhe në anketat tjera statistikore.

Tab. 2. Anketat e zhvilluara me metodë CAPI-CAWI 2019-2021

	Përshkrimi i aktivitetit	2019	2020	2021
1	Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni për kuartet e banimit kolektiv (formulari C1)	NA	NA	CAPI
2	Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni i ekonomive familjare institucionale-kolektive (formulari C2)	NA	NA	CAPI
3	Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni për banesë (formulari R1)	NA	NA	CAPI
4	Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni i ekonomisë familjare (formulari R2)	NA	NA	CAPI
5	Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni individual (formulari R3)	NA	NA	CAPI
6	Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni për anëtarët e ekonomisë familjare të cilët jetojnë jashtë Kosovës (formulari S1)	NA	NA	CAPI
7	Regjistrimi popullsisë - aplikacioni për anëtarët pas regjistrim	NA	NA	CAPI

8	Azhurnimi Qarqeve Regjistruese	CAPI	CAPI	CAPI
9	Anketa për Kostot e Punës	NA	CAPI	CAPI
10	Aksidentet në punë dhe probleme të tjera shëndetësore të shkaktuara në vendet e punës			
11	Anketa e Fuqisë Punëtore	CAPI	CAPI	CAPI
12	Anketa Dhuna në baza gjinore	NA	CAPI	CAPI
13	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	CAPI	CAPI	CAPI
14	SILC	CAPI	CAPI	CAPI
15	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare	CAPI	CAPI	CAPI
16	Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS)	CAPI		
17	PILOTI-Regjistrimi		CAPI	CAPI
18	Anketa e Ekonomive Bujqësore		CAPI	CAPI
19	Anketa e Pemëtarisë	CAPI		
20	Anketa e Hotelerisë	CAWI	CAPI	CAPI
21	Anketa e Statistikave të Energjisë në Ekonomi Familjare dhe Biznese	PAPI	CAPI	CAPI
22	Azhurnimi i RSB	CAWI-CAPI	CAWI-CAPI	CAWI-CAPI
23	Anketa e Investimeve	PAPI	CAPI	CAPI
24	Anketa e Teknologjisë Informative në Biznese	PAPI	CAPI	CAPI
25	PRODCOM	PAPI	CAPI	CAPI
26	ASN - Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve	PAPI	CAPI	CAPI

Metodat e reja të mbledhjes së të dhënave ndikojnë në përafrimin apo zbatimin e parimeve të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (CoP). Modernizimi dhe avancimi i metodave në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave do të vazhdojë edhe në të ardhmen për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin në të gjitha fazat e produktit statistikor gjegjësisht në përpunimin më të shpejtë dhe të automatizuar të të dhënave, eliminimi i pyetësorëve të letrës si dhe eliminimi i nevojës për staf të dedikuar për futjen e të dhënave, kosto më e lirë, etj.

Pajisja e intervistuesve me internet në Tabletë ka mundësuar mbikëqyrësve dhe zyrën qendrore të ASK-së që t'i mbikëqyrin (monitorojnë) vizualisht problemet e mbledhjes së të dhënave. Në çdo anketë, intervistuesit kanë qenë të pajisur me GPS sistem, për t'u siguruar për pozitën e tyre gjatë mbledhjes së të dhënave në terren.

Infrastruktura e TI-së

Infrastruktura e TI-së është e qëndrueshme dhe e sigurt, përkundër një rreziku potencial të vazhdueshëm nga hapësira dhe vjetërsia e vetë objektit të ASK-së. Shpenzimet për TI janë reduktuar me virtualizimin e infrastrukturës së TI-së. Në të njëjtën kohë kjo ka shtuar efikasitetin, përdorimin dhe fleksibilitetin e aseteve ekzistuese.

Përmes pajisjeve për backup në lokacionin primar (në dhomën e serverit kryesor) janë krijuar kopje rezervë të të gjitha të dhënave nga të gjithë serverët në disqet e tij (sistemet e ruajtjes) dhe automatikisht mundësojnë kopjimin e përmbytjes së tij në një lokacion sekondar.


Në funksion të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë nga prizmi i TI-së dhe GIS-it, ASK, ka përgatitur “Dokumentin Strategjik dhe Planifikues për Teknologjinë Informativë, për Regjistrimin e Popullsisë 2022”. Përmes këtij dokumenti janë definuar të gjitha aktivitetet që do të realizohen, për të ndihmuar në të gjitha fazat e Regjistrimit të Popullsisë, veçanërisht teknologjitë e reja që mund të përdoren për aktivitetet e mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

Kapacitetet ne infrastrukturën e TI-se

eDAMIS (Sistemi Elektronik i Administrimit të të Dhënave dhe Menaxhimit të Informacionit)

ASK-ja koordinon aktivitetet dhe bashkëpunon me BQK-në dhe MF për t'i përgatitur të gjitha të dhënat në fushën e statistikave dhe së bashku këto të dhëna i raportojnë në EUROSTAT përmes platformës të krijuar nga Eurostati e ashtuquajtur eDAMIS programi.

Graf. 5: Numri i të dhënave (data sets) të dërguara në Eurostat përmes platformës eDAMIS, 2017-2021



DSBB (Bordi i Buletinit të Standardeve të Shpërndarjes), FMN

Në bashkëpunim me MeF dhe BQK-në, është zbatuar Sistemi i Avancuar i Shpërndarjes së të dhënave të përgjithshme të FMN-së. ASK-ja, në baza mujore dhe tremujore i dërgon të dhënat në FMN, në formatin SDMX, për disa fusha statistikore.

SDMX (Shkëmbimi i të Dhënave dhe Meta datave Statistikore)

Qëllimi i kësaj Iniciative ndërkombëtare nuk përfshinë thjeshtë vetëm standardet teknike të publikimit të të dhënave në formatin open data, por gjithashtu adresimin dhe harmonizimin e termave, klasifikimeve dhe koncepteve për mbledhjen e të dhënave statistikore. SDMX është projektuar për të lehtësuar shkëmbimin dhe përpunimin e automatizuar të të dhënave dhe meta datave midis institucioneve.

ASK përdor SDMX për tri lloje standardesh të meta datave: Standarde për formatet e të dhënave, Standarde për meta datat, si dhe një Arkitekturë të bazuar në regjistrimin e të dhënave për implementimin e këtyre standardeve dhe shkëmbimin e të dhënave midis sistemeve.

Lidhur me shpërndarjen e të dhënave përveç raporteve në formatin PDF, paraqiten edhe në tabela shumëdimensionale dhe përdoruesit mund t'i eksportojnë në formate të ndryshme përmes platformës ASKdata si .xls, csv, Px-Axis dhe html file, JSON-stat file etj.

ASKdata është platformë e bazuar në PX-Web, një zgjidhje për web, e cila përdoret për të krijuar tabelat dinamike në internet nga baza e të dhënave statistikore. Numri i tabelave të integruara në ASKdata deri më tani është mbi 900.

Edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar lidhja e Sistemit të Meta datave (ESMS) në ASKdata sipas temave statistikore.

Mbledhja, mbajtja dhe shpërndarja e meta datave është e një rëndësie të veçante për ASK-në, por edhe për institucionet tjera të Sistemit Statistikor.

ESDS (Qendrën për Mbështetje për Statistika Evropiane)

Që nga viti 2016, ASK-ja si pjesë e sistemit të ESDS-it, përveç që dërgon të dhëna në Eurostat, gjithashtu promovon dhe ofron mbështetje për të gjithë përdoruesit që janë të interesuar për të dhënat e ASK-së por edhe me gjerë. Përmes këtij sistemi, ASK-ja ndihmon përdoruesit e saj në verifikimin e të dhënave, u sigurohen informacione shtesë mbi metodologjinë dhe ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve teknike, duke ofruar përgjigje në gjuhën shqipe. ESDS në gjuhën shqipe menaxhohet nga ASK-ja, në bashkëpunim të ngushtë me Eurostat-in.

SIPK (Sistemi i Përdorimit të Kohës)

Mirëmbajtja harduerike dhe softuerike, konfigurimi i sistemit, niveli i qasjes së përdoruesve si dhe mënyra e veprimit në rast të pasigurisë janë disa nga aktivitetet që ka zhvilluar stafi i TI-së për funksionim normal të sistemit të SIPK-ut.

Siç është shpjeguar edhe më lartë sistemi i SIPK-ut, shërben për t'ju mundësuar përdoruesve në ASK shpërndarjen e orëve duke u bazuar në aktivitetet statistikore në baza ditore, ku pastaj bënë konvertimin e orëve në ditë pune për ti krahasuar me ditët e planifikuara në periudha mujore, tremujore dhe vjetore.

GIS dhe Hartografia

ASK, në kuadër të departamentit për teknologji dhe metodologji ka edhe njësinë e GIS, ku gjatë vitit 2021 përpos punëve të rregullta të ASK-së, stafi i saj ka qenë i angazhuar edhe në projektin e Regjistrimit të Popullsisë.

Digjitalizimi dhe harmonizimi i ndërtesave me Ortofotot e vitit 2018 nga Agjencia Kadastra le e Kosovës për komunat e Mitrovicës, Fushë Kosovës, Malishevë , Rahovec, Kaçanik Graçanicë, Prizren, Podujeve, Ferizaj , Gjakovë , Rahovec, Klinë , Pejë, Viti dhe Suharekë.

Përveç tjerash disa nga aktivitetet me te rëndësishme ne këtë fushe te realizuara gjatë vitit 2021 janë si në vijim; Zgjedhja e mostrës në GIS për Azhurnimin e 350 QR, Dizajn imi i 350 Hartave për nevoja të Azhurnimit të Qarqeve Regjistruese, Azhurnimi i kornizës se mostrës me të dhënat nga Azhurnimi i Qarqeve regjistruese 2020, Lidhja e të dhënave të azhurnimit në GIS në nivel të Qarqeve Regjistruese, Kontrolli i Qarqeve Regjistruese nga formati GIS dhe krahasueshmëria e tyre me kornizën e

Përgjithshme si dhe përditësimi i platformës ASK-Data me publikimet e rregullta të ASK.

Aktivitet mjaft me rëndësi gjatë vitit 2021 i realizuar është edhe Draft imi i rregullores NUTS 3 (propozimet në shtatë rajone statistikore në Republikën e Kosovës).

1.10. *Racionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve në ASK*

Ngritja e kapaciteteve teknike administrative e profesionale është një proces i vazhdueshëm, jo vetëm në shërbimet teknike administrative por edhe ato profesionale në fushën e statistikave të ndryshme sektoriale. Viti 2021, është karakterizuar me vështirësi edhe për shkak të ndryshimeve në kornizën ligjore por edhe për shkak të situatës me Covid 19, si pasojë nuk kanë mundur të plotësohen pozitat e lira nga procesi i pensionimit të stafit. Rrjedhimisht nga ajo që u nënvizua më lartë gjatë vitit 2020-2021 nuk ka pasur asnjë rekrutim edhe përkundër pozitave të lira të punës, për shkak se nuk është lejuar asnjë konkurs nga Institucionet gjegjëse. Me buxhetin për vitin 2020, të aprovuara në total kanë qenë (bugjeti i siguruar respektivisht aprovuar) 166 pozita në ASK, ndërsa deri në fund të vitit 2021, të punësuar kanë qenë 148 punëtorë pra 18 pozita të pambuluara për arsyt e lartcekura.

Në Kosovë, trajnime në fushën e statistikave ende nuk ka të siguruar megjithatë fatmirësisht me përkrahjen e partnerëve tanë, ngritja e kapaciteteve të stafit të ASK-së, ka vazhduar me mbështetjen e fondeve të IPA 2017, si dhe projektit të SIDAs 2018-2022, në sektorë të ndryshëm. Për shkak të pandemisë me COVID 19 në vitin 2020 të gjitha aktivitetet e parapara horizontale si trajnimet, seminarët, grupet punuese, vizitat studimore, konferencat, etj. Janë realizuar përmes platformës online në pamundësi të ardhjes së misionëve të ekspertëve në Kosovë dhe kufizimeve të stafit për të udhëtuar në Eurostat dhe vendet tjera të BE-së.

1.11. *Pasqyrat e Performancës së ASK-së*

Efektiviteti dhe efikasiteti janë ndër parimet bazë në Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP). Andaj, ASK është duke i kushtuar rëndësi gjithnjë e më shumë edhe anës cilësore të prodhimit statistikor, respektivisht matjes së progresit, brenda vetë procesit të prodhimit statistikor. Përveq fazës së planifikimit e cila determinon orientimin në rezultate po ashtu edhe faza e monitorimit konsiderohet proces mjaft i rëndësishëm në kuadër të sistemit menaxhues, lidhur me proceset statistikore në ASK. Përmes sistemit të SIPK-ut, edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar të bëhet matja e performancës në nivel zyrtari, produkti, departamenti dhe në nivel të ASK-së. Performanca matet duke krahasuar gjendjen aktuale me atë të vitit paraprak për numrin e produkteve dhe publikimeve statistikore, kohës prodhuese, numrin e ditëve për produkt, normën e publikimeve në kohë, etj. Rezultatet e prezantuara administrohen përmes Kornizës Vlerësuese të Performancës (KVP-së), në kuadër të së cilës ekzistojnë indikatorët, sistemimi i të cilëve bëhet përmes Sistemit Elektronik për Matjen e Kohës (SIPK-ut) dhe njësisve tjera horizontale.

Produkte/raporte statistikore - Gjatë vitit 2021, në programin e ASK-së, kanë qenë të aktivizuara (ose punë të shpërndara) gjithsej 65 produkte statistikore, krahasuar me vitin 2020, që ishin 62 sosh. Ndërsa numri i publikimeve statistikore gjatë vitit 2021 është regjistruar të jetë 119 sosh, krahasuar me vitin 2020 të cilat ishin 122 raporte statistikore. Si rezultat i Pandemisë Covid 19, disa publikime në kuadër të statistikave sociale gjegjësisht publikimi i të dhënave nga Anketa e Fuqisë Punëtore në baza tremujore nuk kanë mundur të realizohen . Gjithashtu ky ndryshim, vjen si rezultat i serive kohore respektivisht politikës së publikimeve në planet pesëvjeçare e rrjedhimisht edhe ato vjetore, prandaj ka edhe ulje në këtë drejtim. Vlen të theksohet se monitorimi bëhet rreth realizimit të objektivave në Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022.

Numri i ditëve për produkt – Sipas të dhënave të SIPK-ut, krahasues mëria në vitin 2021 në raport me vitin 2020 bëhet me 53 produkte statistikore. Në nivel të ASK-së, për të njëjtat produkte (53 te krahasueshme) në vitin 2020 janë shpenzuar gjithsej 4464 dite-pune krahasuar me vitin 2021, që ishin 5272 dite pune. Siç është cekur më lartë, ASK, bën matjen e performancës (efikasitet veprues-prodhues) edhe në nivel të produktit statistikor. Në vitin 2020 në krahasim me vitin 2021, numri i ditëve për produktet e krahasueshme ka shënuar rritje si rezultat faktorëve të cekur mësipër.

Të dhënat e SIPK-ut, në vitin 2021 kanë regjistruar rritje të numrit ditë pune për produkt nga 84 në vitin 2020 në 99 ditë pune për produkt gjatë vitit 2021 (+17.8%), e që paraqet rënie të efikasitetit prodhues në ASK (numër më i madh i ditëve të punës të materializuara në procesin prodhues). Në nivel të fushave statistikore sektoriale, gjegjësisht Departamenteve Prodhuese, performanca gjegjësisht efikasiteti varion në një shkallë po thuajse të njëjtë në mes të +5% në fushën e publikimeve të përgjithshme deri në +27% më e larta në fushën e statistikave të bujqësisë, statistikave ekonomike rritje me 18% ndërsa ato sociale me 14%.

Koha Prodhuese – Paraqet kohën e publikimit statistikor nga data e fundit, referuar kohës së hulumtimit deri te dita e publikimit. Gjatë vitit 2021, koha prodhuese, ka shënuar një rënie të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak 2020 respektivisht nga 12007 ditë kalendarikë që ishte në vitin 2020 në 10893 ditë kalendarikë në vitin 2021 për produktet e krahasueshme (53 sosh). Pra afati kohor nga data e fundit e hulumtimit statistikor deri tek data e publikimit të raportit në nivel të të gjitha publikimeve statistikore është 12081 ditë kalendarikë apo mesatarisht 101.5 ditë kalendarikë për raport statistikor.

Me fjalë të tjera gjatë vitit 2021, situata është më mirë krahasuar me një vit më parë në nivel të të gjitha publikimeve. Pra ka rënie të kohës prodhuese të përgjithshme nga 13215 ditë kalendarikë në 12081 ditë kalendarikë gjatë vitit 2021, pra është shënuar rënie ndër vite e që është edhe qëllimi i ASK-së.

Norma e publikimeve në kohë – Sipas parimeve të Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP), dhe Ligjit mbi Statistikat Zyrtare, kalendari i publikimeve duhet të publikohet 3 muaj para vitit pasues. Andaj saktësia e publikimit në kohë të Statistikave Zyrtare është jashtëzakonisht e rëndësishme për shfrytëzuesit e statistikave në aspektin e të bërit politika dhe pritjeve për statistika zyrtare. Gjatë vitit raportues nga gjithsej 119 publikime të realizuara (publikuara) 113 prej tyre janë publikuar në kohën e saktë apo 96% e tyre. Ndërsa 6 prej tyre janë publikuar me vonesa siç kemi cekur me lartë tek të dhënat e tregut të punës .

Pasqyrë më të qartë lidhur me zhvillimin e cilësisë pritet të ketë në periudhën e ardhshme, sidomos për indikatorët 7 dhe 8.

Në tabelat e mëposhtme janë dhënë pasqyrat e performancës në nivel të ASK-së dhe në nivel të Departamenteve, sipas treguesve të nxjerrë nga Sistemi Informativ për Përdorimin e Kohës (SIPK).

Tabelat: Pasqyra e Performancës në nivel të ASK-së (SIPK)**Treguesi 1. Numri i produkteve dhe raporteve Statistike 2020/2021**

Fushat Statistike	Produktet		Publikimet	
	Viti 2020	viti 2021	Viti 2020	viti 2021
Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit	12	12	16	16
Statistikat e Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare	26	28	76	79
Statistikat e Sociale	17	18	23	17
Statistikat e Përgjithshme	7	7	7	7
Gjithsej ASK	62	65	122	119

Treguesi 4. Ditë pune – planifikuar dhe realizuar brenda proceseve prodhuese fazat 1-7¹

Fushat Statistike	Planifikimi dhe realizimi i ditëve të punës për produkte statistike për vitin 2021			
	të planifikuara	të realizuara	Dite vlera nominale	Ndryshimi 2021 %
Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit	1153	1175	+22	+2%
Statistikat e Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare	4315	2107	-2208	-51%
Statistikat e Sociale	3114	1925	-1189	-38%
Statistikat e përgjithshme	176	100	-76	-43%
Gjithsej ASK	8758	5307	-3451	-39.4%

Treguesi 4a. Ditë pune - brenda dhe jashtë procesit prodhues (fazat 1-7 dhe 8-11)

Fushat Statistike	Gjithsej dite pune	në procesin prodhues	jashtë procesit prodhues	Proportioni i jashtëm (%)
Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit	1290	1175	115	3.6%
Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare	2288	2107	181	4.9%
Statistikat e Sociale	2316	1925	391	15.6%
Statistikat e përgjithshme	260	100	160	73.7%
Gjithsej ASK	6153	5307	846	13.6%

Bazuar në modelin statistikor GSPBM, model përmes të cilit janë të përshkruara të gjitha fazat statistike në procesin e prodhimit statistikor (nga identifikimi i nevojave deri te procesi i arkivimit pas fazës së shpërndarjes) gjatë vitit 2021, gjithsej në nivel të ASK-së, janë harxhuar 6153 ditë pune. Ndërsa vetëm në proceset prodhuese fazat nga 1-7) janë materializuar në procesin prodhues 5307 ditë pune apo 86.2 % e kohës totale, pjesa tjetër prej 13.8% janë kohë e harxhuar në fazat tjera 8-11 si trajnime, takime, me punë me palët, etj.

¹ Fazat 1-7, Paraqesin fazat e procesit të prodhimit statistikor sipas GSPBM. 1- Identifikimi i nevojave; 7 Disiminimi apo publikimi i Raportit Statistikor

Treguesi 5. Koha prodhuese për produktet e krahasueshme 2020/21 / viti 2021=65/53 produkte të krahasueshme

Treguesi Fushat Statistike	Koha prodhuese		Ndryshimi	
	Viti 2020	Viti 2021	2021-2020	Strukturë (%)
Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit	1725	1726	1	0.06
Statistikat e Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare	6692	5717	-975	-14.5
Statistikat e Sociale	2946	2814	-132	-4.4
Statistikat e përgjithshme	644	636	-8	-1.2
Gjithsej ASK	12007	10893	-1114	-9.2

Siç mund të shihet nga të dhënat e prezantuara në tabelë, koha prodhuese për produktet e krahasueshme e vitin 2021, është më e shkurtër krahasuar me një vit më parë. Respektivisht ASK, ka shfaqur performancë më të mirë në ofrimin e produkteve statistikore tek përdoruesit në një kohë më të shkurtër në shifra absolute për 1114 ditë apo mesatarisht për produkt statistikor rreth 21 dite me shpejtte. Është e ditur se situata me Covid 19, gjatë vitit 2020, ka ndikuar pak në zgjatjen e afatit të prodhimit të disa publikimeve statistikore gjegjësisht ofrimin të të dhënave zyrtare tek shfrytëzuesi. Nga të dhënat e regjistruara përmes sistemit të SIPK-ut, viti 2021 në nivel të ASK-së, ka shënuar rënie për 1114 ditë kalendarike, apo mesatarisht -21 ditë në publikimin e të dhënave statistikore, më herët në krahasim me vitin paraprak.(-1114/53).

Treguesi 5a. Koha prodhuese 2020/21 në raport me bazën 2012/20 (baza =viti 2012, 39 produkte)

Treguesi Fushat Statistike	Koha prodhuese			Ndryshimi (%)	
	Viti 2012 (baza)	Viti 2020	Viti 2021	2021/20	2021/2012
Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit	1082	1112	1096	-1.0%	1.3%
Statistikat e Ekonomike dhe llogaritë kombëtare	3553	2713	2883	+6.0%	-18.8%
Statistikat e Sociale	1450	1651	1194	-28.0%	-17.6%
Statistikat e përgjithshme	193	386	381	-1.0%	97.4%
Gjithsej ASK	6278	5862	5554	-5.0%	-11.3%

Koha prodhuese - Paraqet intervalin kohor nga data e fundit e periudhës të cilit i referohet hulumtimi deri tek data e publikimit të tij. ASK, ja ka synim të saj që sa më shpejtë që të jetë e mundur ti ofrohet produkti statistikor gjegjësisht të dhënat statistikore tek shfrytëzuesi. Për qëllime krahasimi dhe progresi kemi marrë për bazë vitin 2012 (pragu), viti kur është filluar më zbatimin e programit të parë pesë vjeçar 2013-2017.

Në tabelën e më sipërme lidhur me treguesin nr. 5, janë prezantuar të dhënat e kohës prodhuese (përformancës) për produktet krahasuese të vitit 2021 me vitin 2020 (53 produkte). Ndërsa në tabelën treguesi 5a, janë prezantuar të dhënat për vitin 2021 me vitin 2020 si dhe vitin 2021 me bazën respektivisht me vitin 2012. Por në këtë rast krahasimi është bërë me bazën pra me 39 produkte si pikë fillestare. Pra viti 2020 është karakterizuar me sfida si rezultat i pandemisë gjë që ka rezultuar edhe në rritjen e kohës prodhuese, megjithatë në vitin 2021 nga të dhënat e SIPK-ut rezultojnë të ketë performancë më të lartë në raport me një vit më parë, pra koha prodhuese është shkurtuar për 308 ditë kalendarike apo -5.% (për 39 produktet krahasuese). Ndërsa në raport me vitin bazë (2012) në nivel të ASK-së, në vitin 2021 ka një rënie prej -11.3% apo rreth 724 ditë më shpejtë . Mesatarisht për produkt statistikor rreth 18 ditë (724/39) që do të thotë se të dhënat janë publikuar rreth 18 ditë me shpejtë në vitin 2021

krahasuar me vitin 2012 për të njëjtat produkte. Në aspektin e fushave sektoriale, për të njëjtat produkte në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 të dhënat e SIPK-ut regjistrojnë rënie gjegjësisht shkurtim I kohës prodhuese nga - 1.3 më e ulëta deri në -26% më e larta ndërsa në nivel të ASK-së mesatarja është rreth -11.3%.

Treguesi 6. Shkalla e publikimeve në kohë 2021 krahasuar me vitin 2020

Treguesi Fushat Statistikore	Publikime 2020		Publikime 2021		Proporcioni (%)	
	Publikuara	Në kohë	Publikuara	Në kohë	Viti 2020	Viti 2021
Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit	16	15	16	15	94	94
Statistikat e Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare	76	75	79	78	99	99
Statistikat e Sociale	23	19	17	13	82	76
Statistikat e përgjithshme	7	7	7	7	100	100
Gjithsej ASK	122	116	119	113	95	95

Nga të dhënat e mësipërme shihet normë e njëjte e publikimeve në kohë në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak 2020 në nivel të ASK-së. Megjithatë shikuar në aspektin e statistikave sektoriale, performanca nuk është që devijon shumë megjithatë në statistikave të llogaritë kombëtare dhe ekonomike dhe tek statistikave të përgjithshme, nga 99 është në 100%, tek statistikave të bujqësisë dhe ambientit e njëjte me vitin paraprak 94% ndërsa tek Statistikat sociale kemi rënie nga 86 në 73 %, kjo është si pasojë e vonësve të bëra në publikimin e statistikave të tregut të punës, pra publikimet nuk janë realizuar në kohën e saktë sipas kalendarit të publikimeve.

Përfomance përmblendhëse në nivel të ASK-së

Treguesit e KVP	Performanca në nivel Institucional		Ndryshimi	
	Viti 2020	Viti 2021	2021-20	2021/20 %
Treguesi 1. Nr i produkteve	62	65	+3	4.8
Treguesi 1a. Nr i publikimeve	122	119	-3	-2.4
Treguesi 4. Dite pune/produkt	84	99 ²	+15	17.8
Treguesi 5. Koha prodhuese	106	96 ³	-10	-9.4
Treguesi 6. Publikime në kohë	116	113	-3	-2.6
Proporcioni për publikimet në kohë	95%	95%	0	0%

Siç, është shpjeguar edhe më parë, numri i produkteve të aktivizuara në programin e ASK-së, varion sipas programit 5 vjeçar të Statistikave Zyrtare dhe standardeve të caktuara kohore në hulumtimin e një dukurie statistikore. Thënë me fjalë të tjera edhe pse disa nga publikimet statistikore nuk publikohen gjatë vitit përkatës (raportues) ato mbesin të aktivizuara si produkte dhe si rezultat materializohen dite pune (shpenzohet dite pune) për shkak të asaj se frekuenca e publikimit të tyre është më shumë se një vit (2 vjet apo 5 vite). Madje në projektet e mëdha si Regjistrimi i Popullsisë dhe ai Bujqësisë deri në 10 vite. Nga të dhënat e mësipërme mund të konkludojmë se efikasiteti organizativ prodhues në disa tregues ka shënuar rritje si bie fjala (treguesi 4 dhe 5), ndërsa të dhënat për treguesit 1a, kanë regjistruar rënie për shkak të situatës me Covid 19.

² Numri i ditëve për produkt është i bazuar ne 53 produkte te cilat janë te krahasueshme me vitin paraprak

³ Koha prodhuese është e bazuar ne 113 raporte të publikuar te cilat janë te krahasueshme me vitin paraprak

Tabelat: Pasqyra e përfundimit sipas Departamenteve të ASK-së (SIPK)

Fusha e Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare

Treguesi 4. Ditë pune/produkte të planifikuara dhe të realizuara

Viti: 2021, Periudha: Janar - Dhjetor

Prodhimi Statistikor	Ditë pune	Ditë pune	Ditë pune	Ndryshimi
Përmbledhje në nivel të departamentit. Indikator 4	Planif. 2020	Planif. 2021	Realiz. 2021	Plan/real %
Ekonomia jo formale	402	278	0	-
Anketa për Konsumin dhe Efiqencen e Energjisë	0	100	1	-99
Anketa për PRODCOM	137	0	9	n/a
Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve ASN	256	239	77	-68%
Bilanci i Energjisë (Tremujore)	92	93	159	71%
Bilanci Vjetor i Energjisë	0	45	2	-96
Bruto Produkti Vendor sipas Qasjes së Prodhimit GDP	57	51	0	-100%
Bruto Produkti Vendor sipas Qasjes së Shpenzimeve dhe Prodhimit tremujore	1172	1121	0	-100%
Bruto Produkti Vendor sipas Qasjes së Shpenzimeve GDP	58	51	0	-100%
Freskimi i Regjistrimit Statistikor të Bizneseve	136	136	32	-77%
Indeksi i Çmimeve të Importit IMPI	224	24	177	+636%
Indeksi i Çmimeve të Konsumit CPI (Vjetore)	45	9	27	+203%
Indeksi i Çmimeve të Konsumit CPI-HICP (Mujore)	281	68	441	+549%
